



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 20, datë 31.01.2023

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.1, DATË 13.01.2023, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 48342000 (DYZETË E TETË MILION E TREQIND E DYZETË E DYMIJË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHETITORES SË PLAZHIT DURRËS, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KOVALISHENCËS”

Bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; shkresën nr. 546/2 prot., datë 19.01.2023, dalë nga Drejtoria Ligjore, Sektori Juridik, me lëndë “Vënie dijeni”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 13.01.2023, i konfirmuar nga prefekti për bazueshmërinë ligjore me shkresën nr.49/1prot., datë 24.01.2023, sipas relacionit të pregatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 13.01.2022, “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 48342000 (dyzetë e tetë milion e treqind e dyzetë e dymijë) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken

nga investimi publik me objekt: “Projekt zbatimi për ndërtimin e shetitores së Plazhit Durrës, nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës”, si më poshtë:

- a. Ndryshimin e vlerës së shpronësimit nga 48342000 (dyzetë e tetë milion e treqind e dyzetë e dymijë) lekë, e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 13.01.2023, bëhet 42 006 000 lekë, për shkak se ka rezultuar se pasuria me nr. 27/111, ZK 8518 me sip. 400 m², e ndodhur në lagjen nr. 13, Plazh, me vlerë shpronësimi 6336000 lekë, është likuaduar në favor të shtetasit Rami Ismaili, kjo në zbatim të Vendimit nr. (11-2011-201)380, datë 14.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
 - b. Zëvendësimin e tabelës që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 13.01.2023, me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e këtij vendimi.
2. Ky vendim është pjesë e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 13.01.2023.
 3. Ngarkohet Drejtoria Ligjore (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 02.02.2023

BASHKIA DURRËS

LISTA PARAPIRAKE E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI: PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHETITORES SE PLAZHIT DURRESNGA URA DAJLANIT DERI NË GODINËN E I

PRONARI		TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË		
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Z.K	Nr. Pas	Lloji pas	Sip. Tot	Truall	Ndërtes	Volum	Faqe	Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)
Shpronësim tokë "truall"														
1	Ymer		Hajdari	8518	5/58	Truall	433	433	111.8	2	148	760	20000	15200000
2	Mereme		Kila	8518	4/50	Truall	727	727	0	68	156	34.6	20000	692000
3	Dilaver		Mezini	8518	4/49	Truall	73	73	0	68	157	12.2	20000	244000
4	Dashuri	Zija	Hoxha	8518	8/110	Truall	500	500	0	13	98	138.2	20000	2764000
	Dhurata	Hasan	Zela											
	Gezim	Hasan	Hoxha											
	Rahim	Hasan	Korbi											
	Reshit	Hasan	Korbi											
	Shpresa	Hasan	Raxhimi											
	Zenel	Hasan	Korbi											
Behixhe	Hasan	Fortuzi												
5	Zaralanda	Skrat	Kopali	8518	10/32	Truall	120	0	0	26	89	77	20000	1540000
6	Andrea	Sotir	Rexha	8518	10/33	Truall	480	480	0	26	90	352.8	20000	7056000
	Dafina	Izet	Rexha											
	Kristaq	Sotir	Rexha											
	Landi	Sotir	Rexha											
	Lejka	Sotir	Cekani											
	Loreta	Gole	Puleshi											
	Mantola	Gole	Puleshi											
Mitrush	Sotir	Rexha												
Pulie	Sotir	Ciku												
7	Naim	Sadri	Kapiti	8518	27/112	Truall	400	400	94	17	248	195	20000	3900000



8	Abdulla	Dervishi	8518	27/106	Truall	400	400	400	16	244	280.4	20000	5608000
	Aferdita	Keçi											
	Agron	Keçi											
	Dhurata	Kamedani											
	Diamada	Dervishi											
	Dylbere	Nuredini											
	Fatbardh	Dervishi											
	Feride	Kraja											
	Fiqiri	Dervishi											
	Mimoza	Islamaj											
	Muharrem	Dervishi											
	Nurije	Seferi											
	Servete	Gjyzeli											
	Shqipe	Sula											
	Sovjet	Keçi											
9	Rexhep	Mehmeti	8518	27/317	Truall	200	200	200	130	71	92.8	20000	1856000
10	Ermal	Rifat	8518	27/357	Truall	148	148	148	142	99	157.3	20000	3146000
												vlera totale	42006000

Bazuar në përgjigjetjen e DVASHK-Durrës çmimi për llojin e paurisë truall është 20000 l/m².

Grupi i Punës:

Aleks Prenga

Eni Turkeshi

Ervis Bahiti



(Handwritten signatures in blue ink)



09/02/23 273/5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 85 / prot.
8

Durrës, më 09.02.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.20 datë 31.01.2023 “Për disa ndryshime në VKB nr 1 dt 13.01.2023 ”Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 48.342.000 lekë për pasuritë pronë private sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak dhe është pjesë e këtij vendimi që preken nga investimi publik me objekt ” projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së Plazhit Durrës, nga ura e Dajlanit deri në godinën e kovalishencës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

